

# 8.7 milionë euro për riparimin e bllokut A5

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Korporata Energjetike e Kosovës, të mërkurën, nënshkroi marrëveshjen për riparimin emergjent të bllokut A4 të TC "Kosova A", i cili do të kushtojë 8.7 milionë euro.

Projekti i rehabilitimit të pjesshëm të bllokut A4 është financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, ndërkaq punët do t'i kryejnë kompanitë fituese të tenderit konsorciumet THYSSENKRUPP & INTERING dhe WIBREM - INTERING, është bërë e ditur në një njoftim të Zyrës së KEK-ut për informim.

Drejtori menaxhues i KEK-ut,

John Ashley, citohet të ketë thënë se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është shumë i rëndësishëm për KEK-un dhe është në vazhdën e përgatitjeve për të furnizuar më mirë konsumatorët në dëmrin e ardhshëm.

Sipas zëvendësdrejtoreshës Pranvera Dobruna, riparimi parcial i A4-shit bëhet pas riparimit të suksesshëm të bllokut A3 dhe punës që po bëhet edhe në miniera që këto blloqe të furnizohen me qymyr.

"KEK-u, me këtë rast në veçanti falënderoi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës", përfundon njoftimi i Zyrës për Informim të KEK-ut.